



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

ANALIZË VJETORE 2019

RAPORT I ECURISË DHE PERFORMANCËS



ISHMT
Inspektorati Shtetëror i Mbiqëqyrjes së Tregut

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1. Hyrje	4
2. Përshkrim i objektivave/detyrave të realizuara për 2019	4
2.1 Përshkrim i çështjeve/detyrave të realizuara për 2019	5
2.1.1.Inspektime për mbikëqyrjen e tregut për produktet jo ushqimore	5
2.1.2. Inspektime për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	10
2.2. Aktiviteteve sensibilizuese/informuese me operatorët ekonomikë mbi sigurinë e produkteve jo ushqimore dhe mbi pronësinë intelektuale	11
2.3. Ngritja dhe forcimi i kapaciteteteve.....	13
2.4. Mbështetje për plotësimin , përmirësimin dhe përditësimin e legjislacionit sektorial të fushë veprimtarisë së ISHMT-së.....	15
3. Përshkrim i çështjeve/ detyrave të porealizuara ose të realizuara pjesërisht	16
3.1 Arsyet e mosrealizimit të çështjeve të parashikuara për vitin 2019	16
4. Burimet njerëzore	17
4.1 Disiplina në punë; rekordet e orareve të punës.....	17
4.2 Performanca sipas kriterëve.....	17
4.3 Masa disiplinore të marra	17
4.4 Ngritje në detyrë, lëvizje paralele.....	17
5. Masat e ndërmarra lidhur me Taks Forcën e Antikorrupsionit	17
6. Plani i punës për vitin 2020	17
7. Problematikat	18
8 Tabela e realizimit të planit aktual vjetor	18
8.1 Numri i personelit.....	18
8.1 Ankesat	19

LISTA E TABELAVE

Tabela 1:Inspektimet gjatë 2019.....	20
Tabela 2: Inspektime për parapaketim.....	21
Tabela 3:Inspektime për instrumenta ligjërisht të kontrolluara që vendosen në treg	22
Tabela 4:Inspektime për instrumenta ligjërisht të kontrolluara në përdorim	22
Tabela 5:Inspektime për produktet elektrike	23
Tabela 6:Inspektime për ashensorët.....	24
Tabela 7:Inspektime për PMP	24
Tabela 8:Inspektime për makineritë/pajisjet.....	25



ISHMT
Inspektorati Shtetëror i Mbikëqarjes së Tregut

Tabela 9:Inspektime për lodrat	26
Tabela 10:Inspektime për tekstile	26
Tabela 11:Inspektime për mbrojtjen e konsumatorit	27
Tabela 12:Inspektime për të drejtën e autorit	27
Tabela 13:Ankesat e trajtuara nga ISHMT gjatë vitit 2019.....	29

1. Hyrje

Gjatë vitit 2019, ISHMT ka punuar së pari për t'u bërë evident në tregun e produkteve jo-ushqimore dhe në fushën e respektimit të pronësisë intelektuale si një institucion i ri me një përvojë 2-vjecare, që ka në fokus kontrollin e respektimit të kriterëve ligjore sipas fushë veprimtarisë së tij. Kjo është arritur nëpërmjet informimit të operatorëve ekonomik, bashkëpunimit me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe informimit të konsumatorit dhe operatorëve ekonomikë nëpërmjet hapjes dhe përditësimit të informacionit në adresën zyrtare www.ishmt.gov.al.

Së dyti, nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë kësaj periudhe të ndikojë në uljen e mos-konformiteteve të produkteve jo-ushqimore si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Kjo arritje është për t'u nënvizuar për vetë faktin se ISHMT është një institucion relativisht i ri në tregun vendas ku ka mbizotëruar kaosi i shkaktuar nga mungesa e kontrollit të deritanishëm. Inspektimet e vazhdueshme dhe të rregullta në treg, të shoqëruara nga fushata sensibilizuese kanë ndihmuar në përpjekjet institucionale për të arritur këtë Objektiv.

Së treti, për informimin e konsumatorit nga njëra anë mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe nga ana tjetër informimin e operatorëve ekonomikë për të respektuar kërkesat ligjore që janë të shprehura në legjislacionin aktual për të ofruar në treg produkte të sigurta. Kjo është arritur nëpërmjet aktiviteteve, trajnimeve të ndryshme të organizuar me pjesëmarrjen e grupeve të interesit, të fletëpalosjeve, botimeve informuese që jo vetëm janë shpërndarë tek konsumatori dhe operatorët ekonomik por edhe janë pasqyruar në website-n e ISHMT-së .

2. Përshkrim i objektivave/detyrave të realizuara për 2019

Objektivi kryesor

Përmirësim i sigurisë së produkteve për konsumatorët dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale

Objektivi 1: Zbatimi i kërkesave ligjore nga subjektet konform legjislacionit në fuqi për ofrimin e produkteve, pajisje/instalime të sigurta për konsumatorin si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Objektivi 2: Rritje e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë mbi kriteret ligjore që duhet të zbatohen në fushën e sigurisë së produkteve jo-ushqimore dhe pronësisë intelektuale si dhe të konsumatorëve mbi të drejtat e tyre

Përshkrim i çështjeve/detyrave të realizuara për 2019

Për të arritjen e objektivave ISHMT ka punuar për përmbushjen e aktiviteteve të mëposhtme:

2.1. Inspektime për respektimin e kritereve ligjore nga operatorët ekonomikë për produktet joushqimore dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale

Në total nga ISHMT gjatë kësaj periudhe janë kryer 1541 inspektime. Janë vendosur 221 masa administrative në total nga të cilat 117 paralajmërime, 48 gjoba dhe 56 masa urgjente (bllokim , shkatërrim). Janë kontrolluar 14208 produkte nga të cilat 1055 kanë qënë jo në konformitet. (Tab.1)

2.1.1. Inspektime për mbikëqyrjen e tregut për produktet jo ushqimore

Inspektimet për për mbikëqyrjen e tregut për produktet jo ushqimore përfshijnë kontrollin e respektimit të kërkesave ligjore për produktet mekanike, produktet elektrike, qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme si dhe metrologjinë. Gjatë vitit 2019 janë kryer në total 1151 inspektime nga të cilat 997 inspektime të planifikuara dhe 154 inspektime të paplanifikuara të nxitura kryesisht nga ankesat. Janë vendosur 191 masa administrative në total nga të cilat 113 paralajmërime, 22 gjoba dhe 56 masa urgjente (bllokim , shkatërrim). Janë kontrolluar 14208 produkte nga të cilat 1055 kanë qënë jo në konformitet.

2.1.1.1 Metrologjia

Inspektimet në fushën e metrologjisë për vitin 2019 përfshijnë inspektimet për parapaketimet , instrumentat matëse ligjërisht të kontrolluara në përdorim dhe të vendosura në treg. Në total janë kryer 533 inspektime nga të cilat 465 të planifikuara dhe 68 të paplanifikuara mbi bazë ankese. Janë vendosur në total 11 masa administrative nga të cilat 1 paralajmërim, 9 gjoba dhe 1 masë urgjente.

Inspektime për parapaketim

Gjatë vitit 2019 sektori i Metrologjisë ka kryer 282 inspektime të subjekteve që tregtojnë me pakicë produkte të paketuara, të subjekteve prodhues dhe importues të parapaketimeve. Gjatë inspektimeve të produkteve të parapaketuara është bërë edhe kontrolli i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara që kanë në përdorim prodhuesit apo importuesit e produkteve të parapaketuara (kryesisht peshore dhe dozatorë).

Janë kontrolluar 695 produkte nga të cilat kanë qënë jo në konformitet 7 produkte. Janë marrë në total 4 masa administrative nga të cilat 2 masa administrative me vendime gjobë dhe 1 masë administrative paralajmërim, shoqëruar me 1 masë urgjente për kthimin e produktit te parapaketuesi për ripaketim, me qëllim korrigjimin e mospërputhjeve. Gjithashtu janë kontrolluar

edhe 522 instrumente matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim nga prodhuesit apo importuesit e produkteve të parapaketuara. Për këtë kategori produktesh nuk janë konstatuar produkte jo në konformitet. (Tab 2)

Inspektime për Instrumentat matëse ligjërish të kontrolluara që vendosen në treg

Gjatë vitit 2019 sektori i Metrologjisë ka kryer 50 inspektime të subjekteve që importojnë apo prodhojnë instrumente matëse ligjërish të kontrolluara. Janë kontrolluar 38 tipe instrumentesh matëse, nga të cilat 8 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë marrë në total 7 masa administrative me vendime gjobë nga të cilat 3 janë shoqëruar me masë urgjente për ndalim të përkohshëm tregtimi dhe 5 me ndalim të përhershëm tregtimi. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat për këto lloj inspektimesh. (Tab 3)

Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, në përdorim

Gjatë vitit 2019 sektori i Metrologjisë ka kryer 202 inspektime të subjekteve që kanë në përdorim instrumente matëse ligjërish të kontrolluara, kryesisht distributorë karburanti dhe gazi dhe taksimetra. Janë kontrolluar 234 taksimetra, 812 pistoleta karburanti dhe 177 pistoleta gazi. Është marrë në total 1 masë administrative me vendim gjobë, si dhe janë bllokuar 32 pistoleta karburanti, për të cilat është lënë detyrimi për riverifikim dhe 12 pistoleta gazi. (Tab 4).

2.1.1.2. Produkte elektrike

Inspektimet e produkteve elektrike për vitin 2019 përfshijnë inspektimet për produkte që mbulohen nga një rregull teknik si: frigorifere, makina larëse, kondicionerë, furra shtëpiake, aspiratorë, aparate marrëse televizive, si dhe produkte që nuk mbulohen nga një rregull teknik si :adaptorë, priza dhe spina shtëpiake, etj.

Gjatë vitit 2019, ky sektor ka kryer në total 160 inspektime¹ nga të cilat 155 kanë qenë të planifikuara dhe 5 janë kryer mbi bazë ankese. Numri i produkteve të kontrolluara është 11205 nga të cilat 331 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur 51 masa administrative nga të cilat 3 janë gjoba, 36 paralajmërimet dhe 12 masa urgjente. (Tab.5)

2.1.1.3 Produkte mekanike

Në lidhje me këtë sektor rekrutimi i inspektorëve përfundoi në nëntor 2018 dhe tashmë ky sektor ka një numër prej katër inspektorësh.

¹ Në zbatim të Ligjit nr. Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011“Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, Ligjit nr.68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” , VKM Nr. 1061, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” si dhe rregullave teknike të miratuar për disa grup produkte (kondicionerët e ajrit, makinat larëse, pajisje frigoriferike për përdorim shtëpiak, tharëse për përdorim shtëpiak, furra shtëpiake dhe aspiratorët thithës)

Në fokus të inspektimeve për këtë vit kanë qenë ashensorët, Pajisjet e mbrojtjes personale (PMP) dhe makineritë/pajisjet. Në total janë kryer 225 inspektime nga të cilat 217 të planifikuara dhe 8 mbi bazë ankese. Janë vendosur 28 masa administrative gjithsej nga të cilat 26 paralajmërime dhe 2 masa urgjente.

Inspektime për ashensorët

Gjatë vitit 2019 sektori i Produkteve Mekanike ka kryer 209 inspektime të subjekteve që kanë në përdorim ashensorë, apo vendosin në treg (instalojnë apo importojnë) ashensorë dhe komponentët e sigurisë për ta. Janë marrë në total 26 masa administrative paralajmërim. (Tab. 6)

Duke qenë se shkalla e informacionit që kanë komuniteti, bizneset dhe përdoruesit e tjerë të ashensorëve në lidhje me sigurinë e ashensorëve dhe detyrimet ligjore përkatëse është shumë e ulët janë organizuar një sërë takimesh shpjeguese me grupe të ndryshme interesi, trajnime, etj. si dhe janë shpërndarë materiale informuese

Inspektime për PMP

Gjatë vitit 2019, Sektori i Produkteve Mekanike ka kryer 11 inspektime të subjekteve që vendosin në treg pajisje të mbrojtjes personale.

Janë kontrolluar 53 produkte nga të cilat kanë qenë jo në konformitet 4 produkte. Janë marrë në total 2 masa urgjente. (Tab.7)

Inspektimi i makinerive/pajisjeve

Gjatë vitit 2019 sektori i Produkteve Mekanike ka kryer 5 inspektime të subjekteve që vendosin në treg makineri. Për këtë kategori produktesh nuk është marrë asnjë masë administrative. (Tab.8).

2.1.1.4 Qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme

Gjatë vitit 2019 në fokus të inspektimeve të këtij sektori kanë qenë lodrat, produktet tekstile, mbrojtja e konsumatorit², siguria e përgjithshme . Në total janë kryer 233 inspektime nga të cilat 160 të planifikuara dhe 73 të nxitura nga ankesat. Janë vendosur në total 101 masa administrative nga të cilat 50 paralajmërime, 10 gjoba dhe 41 masa urgjente. Janë kontrolluar 1873 produkte në total nga të cilat 652 kanë qenë jo në konformitet.

Inspektimi për sigurinë e lodrave

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 79 inspektime të operatorëve ekonomikë kryesisht importues por edhe shpërndarës të produkteve lodraz. Në total përgjatë vitit 2019 janë kontrolluar 463 produkte

² Në zbatim të Ligjit nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit“, i ndryshuar

³ Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore” dhe VKM Nr. 262/2013 për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”

nga të cilat 81 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur 40 masa administrative nga të cilat vendosur 3 gjoba dhe 37 masa urgjente. (Tab.9)

Në kuadër të festave të fundvitit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka realizuar kontrollet pranë operatorëve ekonomik përgjegjës për vendosjen në treg të këtyre produkteve, duke qënë se kjo periudhë përkon edhe me nivelin më të lartë të bërjes së disponueshme të këtyre artikujve për konsumatorët.

Objekti i kontrollit i këtyre inspektimeve, përveç kontrollit dokumentar dhe fizik në përputhje me legjislacionin e lartëpërmendur vijoi me **kontrollin laboratorik**, në rastet e dyshimeve mbi konformitetin e produkteve të përfshira në kontroll.

Kështu në vijim të kontroleve të realizuara **në 20 operatorë ekonomikë**, importues në nivelin e zinxhirit të furnizimit, në të cilat u morën **42 mostra Lodra** (në përputhje me Urdhër 305/2014 “Për procedurat standardet operationale të detyrueshme për strukturat e mbikëqyrjes së Tregut), rezultoi :

- **11 Lodra** në mospërputhshmëri me karakteristikat fizike/mekanike (EN 71-1) që shfaqin risk të mbytjes/gëlltitjes/prerjeve etj.
- **16 Lodra** me risk kimik, për shkak të nivele të larta të estereve të ftalatit (DEHP, DBP, BBP, DINP, DIDP, DNOP) **mbi nivelin e lejuar <0,1 % në peshë të materialit plastik** dhe klasifikuar si **substancia me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) i kategorisë IB toksik për riprodhimin**.
- **5 Lodra** të kategorisë “Slime”, me risk kimik për shkak të nivel të lartë të migrimit të metaleve të rënda (Boronit), me rrezik dëmtimi të sistemit të riprodhimit.

Për këto produkte (rreth 10 mijë njësi) u morën masat për ndalimin e tregtimit/tërheqjen nga tregu dhe lajmërimin e konsumatorit për riskun e paraqitur. Informacioni mbi lodrat si foto/kod/barkod/numër artikulli/kategoria e riskut u publikua në faqen zyrtare të ISHMT për të informuar publikun e gjerë. Po kështu u realizuan disa dalje në media vizive për të rritur ndërgjegjësimin e prindërve për kujdesin që duhet të tregojnë në përzgjedhjen e lodrave sa më të sigurta për fëmijët e tyre duke kontrolluar markimet përkatëse dhe paralajmërimet.

⁴ VKM Nr. 489/2016 “ Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) e të kritereve për përfshirjen e substancave në listën SVHC dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimine përdorimit të SVHC-ve dhe VKM Nr.319/2019 “ Për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”, REACH-Regulation)

Inspektimet e përbërjes së fibrave të produkteve tekstile

Në lidhje me produktet tekstiles janë kryer 18 inspektime, ku janë kontrolluar 292 produkte nga të cilat 218 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur 7 masa administrative (gjobë) për shkelje të kërkesave ligjore. (Tab.10)

Inspektimet për mbrojtjen e konsumatorëve

Janë realizuar 118 inspektime ku janë kontrolluar rreth 1078 produkte për përmbushjen e detyrimit të informacionit në gjuhën shqipe, treguesin e çmimit në përputhje me Nenin 8,9,12 të Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, " Per mbrojtjen e konsumatoreve", i ndryshuar . Nga këto janë konstatuar 342 produkte jo në konformitet, dhe si rezultat janë vendosur 46 masa administrative paralajmëruese dhe detyra për korigjim të shkeljeve. (Tab.11)

2.1.1.5 Aktivitete të tjera në fushën e inspektimit të produkteve joushqimore

Është realizuar **procedura e shkatërrimit të produkteve joushqimore** (lodra) të cilat kanë rezultuar në jokonformitet me kërkesat minimale të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM Nr.262/2013 “Për sigurinë e Lodrave”. Bashkëpunim me kompaninë e kontraktuar për shkatërrimin e produkteve dhe mbajtja e procesverbalit gjatë procesit dhe administrimi i tij.

Në kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve/ISHMT ka vijuar kontrollin dhe ka dhënë kontributin e saj në vijim të kërkesave nga DPD **për kontrollin formal dhe dokumentar të produkteve joushqimore që kalojnë në pikat doganore**. Nga ana e ISHMT-së është ofruar asistencë teknike kontrollit fizik doganor mbi kriteret e detyrueshme për vendosjen në treg sipas Ligjit Nr.10489/2011 të instrumentave matës, ashensorëve dhe pjesëve të sigurisë së tyre, etj.deklaruar për import pranë Degës Doganore Durrës

Në lidhje me **ALERT-et ndërkombëtare të njoftuara nga sistemi i Komisionit European RASFF(Rapid Alert System Feed and Food) të kategorizuara** me risk serioz me ndikimin në shëndetin e njeriut, prej produkteve joushqimore të kategorisë “material në kontakt me ushqimin” përkatësisht: 1. *Pjatë prej melamine me emër “Frozen Snow Flakes Plate”* me përmbajtje të lartë të mgrimit të melaminës, 2. *“Filxhan çaji me fibra bambuje (Bambo Fiber Mug) me përmbajtje të lartë të mgrimit të melaminës* 3. *“Garuzhde plastike me dorezë silikoni”*, me nivel të lartë të migrimit të aminave aromatike parësore 4. *Pjatë prej porcelani për përdorim të përditshëm”* me migrimit të plumbit mbi nivelin e lejuar. Nga ana ISHMT-së u kryen inspektimet duke lënë detyrim “marrjen e masave për lajmërimin e konsumatorëve nëpërmjet kanaleve të përshtatshme të komunikimit si dhe kthimin mbrapsht të produktit nga ky i fundit”, u njoftua Dogana për

⁵ Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011“Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore” dhe VKM nr. 1058, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile”.

ndalimin e zhdoganimit për qarkullim të lirë të këtyre produkteve si dhe u publikua në web-site e ISHMT-së u vendos njoftimi për informimin e konsumatorëve mbi rrezikshmërinë e këtij produkti në formën e pop-up dhe tek rubrika njoftimet (<http://ishmt.gov.al/njoftimi-i-kategorise-alert-nderkombetar-ne-portal-in-rasff-rapid-alert-me-numer-notifikimi-386007-per-produktin-pjata-per-femije-te-bere-prej-melamine/>)

Në lidhje me **sigurinë e ashensorëve në kushtet e situatës emergjente** për shkak të lëkundjeve sizmologjike të ndodhura në datën 21 Shtator 2019, që shkaktoi dëme materiale dhe në mënyrë të veçantë në funksionimin e ashensorëve në ndërtesat e banimit dhe në institucione të tjera si: qendra tregtare, spitale, hotele, qendra biznesi, etj. , ISHMT ndër morri veprime monitoruese dhe inspektuese në zonat më problematike me objekt rritjen e sigurisë së ashensorëve në përdorim, si dhe të shmangies se problematikave të shkaktuara nga lëkundjet sizmologjike.

Gjithashtu edhe në kushtet e **situatës së emergjencës** për shkak të goditjeve të tërmetit të datës 25 Nëntor 2019, në fokus të punës së ISHMT-së ishte informimi i banorëve, përdoruesve të ashensorëve, administratorëve të banesave, personave përgjegjës që të merrnin masa për mospërdorimin e ashensorëve që i ishin nënshtruar lëkundjeve pa u kontrolluar dhe verifikuar paraprakisht nga persona kompetentë për sigurinë e tyre. Përfaqësues të ISHMT-së kontaktuan dhe bashkëpunuan me pjesën më të madhe të mirëmbajtësve të ashensorëve për zonën e Tiranës, Durrësit dhe Lezhës si dhe me Administratorët e banesave për 11 njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, për të patur në kontroll sigurinë e njerëzve , përdorues të ashensorëve për evitimin e dëmeve dhe risqeve të shkaktuara nga situata pas tërmetit.

2.1.2. Inspektime për respektimin e të drejtavë të pronësisë intelektuale

Inspektimet për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale përfshijnë inspektimet për Pronësisë Industriale dhe për të Drejtën e Autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me to.

Gjatë vitit 2019 janë kryer në total 390 inspektime nga të cilat 311 kanë qenë inspektime të planifikuara dhe 79 inspektime të paplanifikuara kanë qenë mbi bazë ankese. Janë vendosur 42 masa administrative nga të cilat 31 gjoba dhe 11 paralajmërime.

2.1.2.1. Inspektimi mbi të drejtën e autorit

Në fokus të inspektimeve të Sektorit të të drejtavë të autorit kanë qenë: Inspektimi i programeve kompjuterike, veprave audiovizuale, fotokopje, shtëpi botuese, shtypshkronja, librari.

Gjatë vitit 2019, janë kryer në total **386 inspektime**⁶, nga të cilat 75 kanë qenë të nxitur nga ankesa. Janë informuar 600 subjekte. Janë vendosur 40 masa administrative nga të cilat 29 gjoba dhe 11 paralajmërime. (Tab.12)

⁶ Në zbatim të Ligjit Nr. 35/2016 datë 31.03.2016 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të lidhura me to” për subjektet /përdorues të programeve kompjuterike

2.1.2.2. Inspektive mbi pronësinë industriale

Inspektimet mbi pronësinë industriale janë inspektive që kryhen vetëm mbi bazë ankese nga subjekte të ndryshme në zbatim të ligjit Ligjit organik Nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar. Janë vendosur 2 masa administrative nga të cilat 2 gjoba në vlerën 100,000 lekë.

2.2. Aktiviteteve sensibilizuese/informuese me operatorët ekonomikë mbi sigurinë e produkteve jo ushqimore dhe mbi pronësinë intelektuale

Në total nga ISHMT gjatë kësaj periudhe janë realizuar 8 takime për informimin e operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve, disa emisione televizive, botimi dhe shpërndarja e 1 fletëpalosje (tirazhi 1000 copë) dhe 1 poster (tirazhi 150 copë).

- ✓ **Takim me përfaqësues të bizneseve** në bashkëpunim me Dhomën e Tregëtisë Amerikane në 20 Mars 2019, ku ju bë prezent misioni dhe fushë veprimtaria e ISHMT-së.
- ✓ Në 8 Mars 2019 **takim me importuesit e ashensorëve dhe komponentëve të sigurisë** për njohjen e detyrimeve të tyre në lidhje me zbatimin e legjislacionit aktual mbi sigurinë e ashensorëve.
- ✓ Takim me bizneset në Berat në bashkëpunim me USAID (5 Mars 2019).
- ✓ Në ditën e Europës, 09 Maj 2019, Qendra “Konsumatori Shqiptar” në bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, zhvilluan **takim me temë “Sfidat e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqarjes së Tregut (ISHMT) në garantimin e sigurisë për produktet joushqimore në kuadër të procesit të antarësimit në BE”**. Ky aktivitet me përfaqësues të administratës publike, gazetarë, shoqëri civile si dhe qytetarë nga Durrësi, kishte në fokus mbrojtjen e konsumatorit për kategorinë e produkteve joushqimore. Përfaqësuesit e ISHMT-së shpjeguan me detaje rolin dhe veprimtarinë e inspektoratit në një pjesë të fushave që ai mbulon si: lodra, detergjentë, produkte elektrike dhe ashensorët. Në fund të secilit prezantim, pjesëmarrësit kishin mundësi që të drejtonin pyetje lidhur me tematikat e zhvilluara dhe ndërgjegjësimin e tyre si konsumatorë.
- ✓ Është realizuar **takim me bizneset e Fierit** më datë 24 Maj 2019, në kuadrin e Takimit të V “Për Zhvillimin Ekonomik Vendor” të Projektit PLGP të USAID, në bashkëpunim me bashkinë e Fierit. Në pjesën e dytë të takimit përfaqësuesit e ISHMT-së prezantuan për të pranishmit misionin, strukturën dhe fushën e veprimtarisë së këtij inspektorati. Më pas u ndalën në informimin e operatorëve ekonomikë mbi: procedurën e inspektimit, të drejtat dhe detyrimet

e inspektorëve dhe operatorëve ekonomikë; kërkesat ligjore që duhet të respektohen nga operatorët ekonomikë në lidhje me sigurinë e produkteve jo ushqimore (instrumentat matëse të kontrollueshme, parapaketime, lodra, detergjentë, pajisjet elektrike, ashensorët, etj.); respektimin e të drejtave të pronësinë intelektuale.

- ✓ Në kuadër të 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, **ISHMT organizoi një aktivitet me qëllim rritjen** e ndërgjegjësimit të prindërve mbi rëndësinë e përzgjedhjes së produkteve për kujdesin e fëmijëve të tyre. Në këtë aktivitet u shpërndanë materiale informuese si fletëpalosje dhe postera, mbi paralajmërimet që duhet të shoqërojnë produktet si *rrethore, takëmet e ngrënies të fëmijëve, biberonat, mbajtësit e tyre* si dhe instruksionet e përdorimit dhe të mirëmbajtjes, të cilat duhet të kontrollohen dhe lexohen me vëmendje për të shmangur rreziqet që ato mund paraqesin.



- ✓ **Takim me instaluesit, mirëmbajtësit për sigurinë e ashensorëve** në datën 19 Nëntor te Hotel Kotoni. Ky takim konsistonte në informimin e instaluesve, mirëmbajtëseve, administratorëve në informimin e tyre mbi ndryshimet e fundit ligjore në lidhje me sigurinë e ashensorëve që duke filluar nga 1 Janar 2020 të gjithë ashensorët që do të vendosen në shërbim do të duhet të jenë të

markuar me certifikatën e sigurisë CE.

- ✓ Më datë 21 Nëntor 2019 u zhvillua një **takim informues me studentët e Universitetit “ Marin Barleti”** i cili konsistonte në njohjen e veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe kryesisht mbi rëndësinë e të drejtave të pronësisë intelektuale. Gjatë këtij takimi u diskutua për rëndësinë e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire* dhe kontributin e Inspektoratit në raportimin për Kapitullin 1, 7, 28 në Planin Kombëtar të Integritimit Europian.

Është botuar dhe shpërndarë një fletëpalosje dhe 1 poster për sensibilizimin e prindërve dhe të gjithë opinionit publik për sigurinë e artikujve të kujdesit për fëmijë.

Është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme **informacioni në web-site** e ISHMT-së www.ishmt.gov.al, i cili në kuadrin e Projektit “Technical assistance for carrying out efficient market surveillance po bëhet edhe në gjuhën angleze.



Për ndërgjegjësimin e qytetarëve, prodhuesve, tregtarëve, instaluesve, për sigurinë e lodrave dhe të ashensorëve janë realizuar 7 intervista në Top Channel, Scan TV, ATSH, Fax News, etj. me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ISHMT-së.

2.3. Ngritja dhe forcimi i kapaciteteteve

Në total janë kryer 10 trajnime me pjesëmarrjen e 39 inspektorëve. 15 inspektorë janë trajnuar dhe më shumë se dy herë.

- ✓ Në kuadrin e Projektit “Technical assistance for effective Market Surveillance” në 12 Shkurt 2019 u zhvillua **trajnimi mbi lodrat (tool box for toys)** që konsistonte në përdorimin e Tool box për kontrollin në se lodra është e sigurtë në lidhje me karakteristikat fizike, mekanike e elektrike.
- ✓ Në kuadrin e Projektit “Technical assistance for effective Market Surveillance”, më datë 12 Prill 2019, u zhvillua trajnimi **“Hartimi i listës së verifikimit për produktet lodra sipas kategorive”** referuar standartit të lodrave EN 71-1, ku u trajtuan kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë një lodër për tu konsideruar e sigurtë, duke përmendur modelin, markën, prodhuesin, vendin e origjinës, importuesin etj si dhe krijimi i listë verifikimeve për disa kategori produktesh që konsiderohen si lodra .
- ✓ Më datë 18 Prill 2019 u organizua **trajnimi mbi “Njohja me procedurat doganore”** me pjesëmarrjen e inpektorëve të ISHMT-së, qëllimi i të cilit ishte rritja e efektivitetit te bashkëpunimit mes ISHMT-së dhe Autoriteteteve Doganore duke u njohur me procedurat doganore që këto të fundit ndjekin në përputhje me Kodin Doganor.
- ✓ Më datë 3 maj 2019 u organizua **trajnimi mbi “Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit”**, për njohjen më në thellësi të këtij ligji duke u fokusuar në dispozitat për të cilat ngarkohet ISHMT për kontrollin e zbatimit të tyre si dhe në amendimet e fundit të tij në vitin 2018.

